



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2689 Prot

Tiranë, më 11.10.2019

**THIRRJE**

**PËR PARAQITJEN E SHPREHJES SË INTERESIT NGA PROKURORËT  
PËR  
ANËTAR NË KËSHILLIN DREJTUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

Në kushtet e vakancës së krijuar në Këshillin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, për shkak të shkarkimit nga detyra të anëtarit prokuror, bazuar në nenin 247, pika 1, shkronja “d” dhe pika 2, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Prokurori i Përgjithshëm shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për prokurorët që dëshirojnë të kandidojnë për t’u zgjedhur anëtarë të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Njoftohen të gjithë prokurorët që dëshirojnë të konkurojnë, që brenda datës **01.11 2019**, të shprehin interesin e tyre përmes një kërkesë me shkrim, të dorëzuar personalisht në institucion apo nëpërmje postës, në adresë të Prokurorit të Përgjithshëm, ose me e-mail në adresën elektronike [Enkeleida.Zotkaj@pp.gov.al](mailto:Enkeleida.Zotkaj@pp.gov.al)

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të kenë punuar si prokurorë për jo më pak se **5 vjet**;
- b) të mos jenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

Kjo thirrje u dërgohet të gjithë prokurorëve në adresën elektronike zyrtare.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU

